

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6723
E mërkurë, 5 tetor 2022
çmimi 0.40 €

Fillon zhdoganimi në Portin e Durrësit për mallrat me destinacion Kosovën | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

QEVERIA KURTI SHKAKTON PAKËNAQËSI TË MËDHA PAS MOSEKZEKUTIMIT TË PAGAVE PËR MËSIMDHËNËSIT

Avokati i Popullit, kryetarë të komunave, Këshilli i Prindërve i Kosovës, shoqëria civile, gjashtë deputetë të grupit parlamentar të LV-së, partitë opozitare kanë shprehur pakënaqësi të mëdha për mosekzekutimin e pagave për mësimdhënësit për muajin shtator. Avokati i Popullit, Naim Qelaj, ka thënë se mosekzekutimi i pagave të mësimdhënësve do ta rrezikojë seriozisht mirëqenien sociale për mësimdhënësit dhe për familjet e tyre



LV-ja S'I DURON KRITIKAT, I AKUZON QEVERTË E KALUARA PËR "SHKATËRRIM TË SHTETIT"



VETËVENDOSJE!



Rreth Kosovës së përbashkuar



si ryshfet, si haraç,



si krim, si korrupsion

Lëvizja Vetëvendosje, e cila ka pushtetin absolut në Kosovë, është duke u ballafaquar me kritika të shumta për mënyrën se si është duke qeverisur vendin. E përballur me këto kritika, partia e Albin Kurtit ka zgjedhur ta publikojë një video nëpërmjet së cilës i ka akuzuar qeveritë e kaluara për, kinse, shkatërrim të shtetit. Në këtë video Vetëvendosja nuk

i ka kursyer as liderët e UÇK-së të cilët gjenden në paraburgim në Hagë që nga nëntori i vitit 2020 si dhe drejtuesit e SBASHK-ut. Një video e tillë ka ngjallur reagime të opozitës dhe të një pjese të shoqërisë civile. Sipas tyre, partia në pushtet është mashtruese dhe shantazhuese, ndërsa kryeministri Kurti është kryemashtues

AKTUALE



SHBA-ja PRITET TË DËRGOJË NË UKRAINË MË SHUMË HIMARS DHE ARMË TË TJERA F.5

TRUSS I SHKRUAN KURTIT: MBRETËRIA E BASHKUAR DHE KOSOVA JANË NË NJË LINJË F.5

KONJUFCA PRET MBËSHTETJEN E FRANCËS PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE F.7


EKONOMI



PUSHTIMI RUS I UKRAINËS PENGON RIMËKËMBJEN PAS PANDEMISË TË EKONOMIVE TË REJA TË EVROPËS DHE AZISË QENDRORE F.8

KOSOVA DHE ZVICRA SHPREHIN PËRKUSHTIM PËR FINALIZIM SA MË TË SHPEJTË TË MARRËVESHJES EFTA F.8

SPORT



CHELSEA KËRKON FITOREN E PARË NDAJ MILANIT F.10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni Xhepcisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

ShBA-ja pritet të dërgojë në Ukrainë më shumë HIMARS dhe armë të tjera



UASHINGTON, 4 TETOR - Administrata e presidentit amerikan Joe Biden pritet që në pakon e re të ndihmës së sigurisë për Ukrainën të përfshijë katër sisteme raketore me lëvizshmëri të lartë (HIMARS), raketahedhës, municion, mina dhe makina të blinduara. Kështu i thanë "Reuters"-it dy burime që kanë njohuri për paketën e re të ndihmës që pritet të jetë në vlerë prej 625 milionë dollarësh. Njoftimi për paketën e re të ndihmës pritet të bëhet të martën dhe kjo do të jetë ndihma e parë amerikane për Ukrainën, qëkur Rusia pretendoi se ka aneksuar katër rajone ukrainase.

Rusia këtë njoftim e bëri pas mbajtjes së referendumeve të rreme në rajonet e Donjeckut, Luhanskut, Zaporizhjes dhe Hersonit, që janë pjesërisht të pushtuara nga forcat ruse. Sistemet HIMARS dhe raketat përcjellëse, por edhe armët e tjera mund të dërgohen në Ukrainë në ditët në vijim. Paketa e re e ndihmës është në kuadër të Autoritetit për Tërheqje Presidenciale, që i lejon ShBA-së të transferojë armë dhe mjete ushtarake nga stoqet e ushtrisë së saj dhe nuk kërkohet miratimi i Kongresit për një gjë të tillë. Javën e kaluar ShBA-ja njoftoi për një pako të armëve për Ukrainën

në vlerë prej 1.1 miliardë dollarësh, ku përfshiheshin 18 HIMARS dhe armë të tjera, përfshirë edhe sisteme radarësh dhe sisteme kundër dronëve. Por, kjo pako ishte në kuadër të Nismës për Asistencë të Sigurisë për Ukrainën, që nënkupton se qeveria amerikane merr armët që janë të destinuara për Ukrainën nga kompanitë prodhuese të armëve dhe jo nga stoqet e ushtrisë. Deri më tani në Ukrainë janë dërguar 16 HIMARS të ShBA-së. Me pakon e re, ndihma që Uashingtoni ka ofruar për Kievin qëkur ka nisur pushtimi rus i Ukrainës, arrin në vlerën mbi 16.8 miliardë dollarë.

Gjermania i analizon "me shumë seriozitet" kërcënimet bërthamore të Putinit

BERLIN, 4 TETOR - Qeveria gjermane i analizon "me shumë seriozitet" kërcënimet bërthamore të presidentit rus, Vladimir Putin, ka thënë ministrja e Jashtme gjermane, Annalena Baerbock. Megjithatë, ajo ka thënë se Berlioni nuk do të lejojë që të shantazhohet nga Moskë. "Ne i analizojmë fjalët e tij me shumë seriozitet, gjithçka tjetër do të ishte neglizhencë", ka thënë ajo për gazetën "Neue Osnabrücker Zeitung". Putini e ka dëshmuar disa herë se ai nuk u shmanget krimeve më të

këqija të luftës, ka thënë Baerbock. Prapëseprapë, sipas saj, Putini e kupton se "asnjë shtet në botë, as ato, sikurse Kina - që nuk kanë marrë pozicion të qartë - nuk do të pranojnë të luajnë me zjarrin në këtë çështje". "Ne nuk duhet, dhe as nuk do t'i nënshtrohemi shantazhit - Putini do të shihte diçka të tillë si ftesë për përshkallëzim të mëtutjeshëm". Baerbock ka thënë se është e bindur që presidenti rus është duke humbur mbështetjen në botë. "Janë shumë pak shtete që ende e mbështesin Putinin,

qindra mijëra rusë të rinj janë duke ikur nga shteti. Presidenti rus është më i izoluar dhe më i vetmuar se kurrë më parë". Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt. Vetë Putini e quan luftën si "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.



Çmimi Nobel për Fizikë u ndahet tre shkencëtarëve



STOKHOLM, 4 TETOR - Çmimi Nobel për Fizikë u është ndarë tre shkencëtarëve: francezitet Alain Aspect, amerikanit John Clauser dhe austriakut Anton Zeilinger për zbulimet e tyre në fushën e mekanikës kuantike. Kjo shkencë e përshkruan natyrën në format e saj më të vogla. Puna e tyre mund ta hapë rrugën për një gjeneratë të re,

potencialisht të pathyeshme, të kompjuterëve dhe sistemeve të komunikimit. Ky çmim i vjetër më shumë se një shekull ka vlerën e 902.315 dollarëve amerikanë dhe ndahet nga Akademia Mbretërore e Shkencave e Suedisë. Nobeli për Fizikë është çmimi i dytë që ndahet këtë javë, pasi suedezi Svante Paabo është


nderuar në fushën e Mjekësisë më 3 tetor. Në ditët në vazhdim do të ndahen çmimet Nobel për Paqe, Letërsi, Kimi dhe Ekonomi. Ceremonia zyrtare e ndarjes së çmimeve mbahet më 10 dhjetor për ta shënuar përvjetorin e vdekjes së Alfred Nobelit (1833-1896). Ai njihet për shpikjen e dinamitit.

Japonia dëbon një diplomat rus

TOKIO, 4 TETOR - Tokio ka urdhëruar që një zyrtar i lartë rus të largohet nga shteti pasi Rusia para një jave dëboi një diplomat japonez nën dyshimet për spiunim. Ministri i Jashtëm japonez, Yoshimasa Hayashi, tha më 4 tetor se konsulli rus në qytetin verior Saporu do të dëbohet "si kundërpërgjigje ndaj veprimeve të Rusisë".

Kjo deklaratë erdhi pasi Rusia tha më 26 shtator se një diplomat japonez në qytetin lindor të Vladivostokut u arrestua dhe u urdhërua të largohej nga vendi nën dyshimet për spiunazh, duke pretenduar se konsulli kishte kërkuar që të merrte informacione "të kufizuara". Moskë tha se diplomati, i

identifikuar si Motoki Tatsunori, u kap duke pranuar informacione mbi efektet ekonomike të sanksioneve perëndimore ndaj Rusisë në këmbim "të shpërblimit monetar". Ministria e Jashtëm ruse tha se Tatsunori ishte shpallur person non grata dhe i ish dhënë 48 orë afat për t'u larguar nga Rusia.



LV-ja s'i duron kritikën, i akuzon qeveritë e kaluara për 'shkatërrim të shtetit'

- Opozita: Kryeministri Albin Kurti është kryemashtruesi i Kosovës



Lëvizja Vetëvendosje, e cila ka pushtetin absolut në Kosovë, është duke u ballafaquar me kritika të shumta për mënyrën se si është duke qeverisur vendin. E përballur me këto kritika, partia e Albin Kurtit ka zgjedhur ta publikojë një video nëpërmjet së cilës i ka akuzuar qeveritë e kaluara për, kinse, shkatërrimin e shtetit. Në këtë video Vetëvendosja nuk ka kursyer as liderët e UÇK-së të cilët gjenden në paraburgim në Hagë që nga nëntori i vitit 2020 si dhe drejtuesit e SBASHK-ut. Një video e tillë ka ngjallur reagime të opozitës dhe një pjesë të shoqërisë civile. Sipas tyre, partia në pushtet është mashtruese dhe shantazhuese, ndërsa kryeministri Kurti është kryemashtruesi

EPOKA
ERE

Lirim GECI

PRISHTINË, 4 TETOR - Qeveria e Kosovës, e drejtuar nga kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, është duke u ballafaquar me kritika të ashpra për mënyrën se si është duke qeverisur vendin. E përballur me këto kritika, Vetëvendosja ka vendosur ta sulmojë opozitën dhe çdo përfaqësues të institucioneve që del kundër saj. Në ditë më parë kjo parti ka publikuar një video, nëpërmjet së cilës i ka akuzuar qeveritë e kaluara për mënyrën se si kanë qeverisur me Kosovën. Në këtë video Vetëvendosja ka portretizuar Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Isa Mustafën, Ramush Haradinajn, Fatmir Limajn, Behgjet Pacollin, Memli Krasniqin, Lumir Abdixhikun, Sami Lushtakun si shkatërrues të shtetit. Po ashtu, Vetëvendosja ka portretizuar edhe drejtuesit e SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj dhe Ymer Ymerin, si shkatërrues të shtetit. Në këtë video Vetëvendosja dhe Albin Kurti janë portretizuar si shpëtimtarë të Kosovës. Ajo që bie në sy është se në këtë video nuk është presidentja Vjosa Osmani, e cila në të kaluarën ka qenë pjesë e LDK-së. Në Kosovën e pasluftës asnjëherë nuk ka ndodhur që një parti në pushtet të bëjë fushatë të tillë kundër opozitës së sotme.

"Shkatërruesit e shtetit që nuk duan ta shohin Kosovën mirë për 20 vjet kanë qeverisur vendin. Herë vetëm e herë njëri me tjetrin. Formalisht të ndarë në parti të ndryshme por, praktikisht, në një qëllim: rreth Kosovës së përbashkuar që e shihni veç si tender, si ryshfet, si haraç, si krim, si korrupsion e si çka tjetër. Ishte vetëm një subjekt që s'ishte në anën e tyre, Vetëvendosje!", është thënë në mbishkrimin e videos së publikuar nga Vetëvendosja.

Opozita e quan Albin Kurtin kryemashtrues

Kjo video e Vetëvendosjes ka ngjallur reagime të shumta nga përfaqësuesit e opozitës, gazetarëve dhe një pjesë e shoqërisë civile. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se me këtë video propaganduese Albin Kurti ka treguar se kurrë nuk do të bëhet lider, përpos një përçarës kronik. "Prej ndëshkimit diskriminues për të gjithë mësimdhënësit, përmes ndalesës jologjore të pagave, e deri te videoja propaganduese për të nxitë edhe më shumë urrejtje e ndasi, Albin Kurti edhe sot tregoi që kurrë nuk do të bëhet lider, por do të mbetet vetëm një përçarës kronik. Kryeministri është kryemashtruesi i Kosovës. Shumë shpejt i doli

bojal", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Ndërsa kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se Albin Kurti me videon e publikuar është treguar njeri i vogël. "Në vend të qetësisë dhe përafërimit, Albin Kurti kërkon tension. Ai s'mund të jetojë pa krizë, prandaj i dënon mësimdhënësit e vendit. Është njeri i zymtësisë, arrogancës e i ndjelljes së frikës. Është politikan i paaftësisë. Si i tillë, është gjithçka përveçse kryeministër. Sot u tregua dhe njeri i vogël. Në prag të dimrit të vështirë, në vazhdimësi të papërbalueshmërisë, në stagnim ekonomik e në ikje masive, ai vendosi t'i tregojë dhëmbët. Dhe për kë? Për mësimdhënësit e vendit, shtresën më të goditur nga kriza. Mashtrimi populist s'duket ndryshe. Dje ishte shfrytëzues i kauzave të tyre, sot është bërë dënues kolektiv në mes të krizave. Mësimdhënësit e vendit, ata që u bënë tabelë qitjeje nga ushtritë digjitale të pushtetit, ta kuptojnë se qeveritë janë të përkohshme, por shteti mbetet i përhershëm. Këto paga do t'u paguhet - herët apo vonë. S'ka forcë që jua merr të drejtën mbi to. Merreni këtë si zotim publik timin dhe të LDK-së. Deri atëherë ne do të bëjmë çdo përpjekje të mundshme, ta detyrojmë pushtetin mashtrues t'i ekzekutojë pagesat", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook".

Ndërsa lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se më shkatërrues se qeveria Kurti nuk do të ketë në Kosovë edhe nja 100 vjet. "Më shkatërrues se këta njerëz të shtetit nuk ka me njoftë më qeverisja në Kosovë, të paktën nja 100 vjet. Çdo ditë e lume, një muaj i këtyre është sa një vit i dikujt tjetër me bë dëme. Janë edhe hajna edhe hararegji, edhe çdo gjë janë. Ato i kanë pasur veç me i mashtruar qytetarët, veç me e marrë votën", ka thënë Haradinaj në një debat

televiziv.

Në debatin për këtë video të Vetëvendosjes është përfshirë edhe gazetari shumëvjeçar Halil Matoshi. Ai ka thënë se kjo video është në stilin e doktrinës së Beogradit. "Doktrina e Beogradit: Të bindën kosovarët se gjatë 20 vjetëve kishte veç shkatërrim. Milicët sekrete serbe dhe ruse e kanë promovuar ndër shqiptarë tezën se Kosova shtet është e pajtueshme, me elita zhatëse e kriminale, thjesht shtet i dështuar. Spoti i Lëvizjes Vetëvendosje sot, është e instruktues si ide dhe projekt i Beogradit dhe Nishit (baza e spiunazhit rus) dhe e financuar me taksat e qytetarëve kosovarë", ka shkruar Matoshi në "Facebook". Edhe analisti politik, Petrit Zogaj, ka thënë se videoja e Vetëvendosjes ngjan me videolipet e të

ashtuquajturës "Zyrë për Kosovën" në Qeverinë e Serbisë. "Kosova është shkatërruar gjatë viteve '90-a, kur kishim sistem apartheid të instaluar nga Serbia. Gjithçka që ka ndodhur nga 1999 e këtej ka qenë vetëm në funksion të ndërtimit. Është ndërtuar Kosova dhe janë ndërtuar institucionet e saj. Është bërë shteti me një fjalë. A ka pasur gabime? Sigurisht që po. Shumë madje. Por të thuash që për 20 vjet Kosova vetëm është shkatërruar, kjo më shumë se çkado tjetër, po duket me qenë si ndonjë videoklip i të ashtuquajturës "Zyra për Kosovë" në Qeverinë e Serbisë. Është e turpshme me pa video të partisë në pushtet, e cila në vend që të merret me problemet që i ka përpara, bën video se si na qenka shkatërruar Kosova e pasluftës. Të paaftë e mashtrues", ka shkruar Zogaj në "Facebook".

Lushtaku: Unë dhe bashkëlufetarët jemi mësuar më këso videosh nga koha e Millosheviqit

Nënkryetari i komunës së Skenderajt, Sami Lushtaku, ka qenë më i ashpëri pas publikimit të videos së Vetëvendosjes. Fillimisht Lushtaku ka thënë se i vjen keq që në video janë vendosur drejtuesit e UÇK-së që janë në Hagë. "Më erdhi keq për ata që janë në Hagë. Unë edhe ata që janë në Hagë jemi mësuar me këso videosh në kohën e Millosheviqit, kur fotografia ime dhe e bashkëlufetarëve të mi ka qenë vazhdimisht në mjetet e informimit serb", ka thënë ai në një debat televiziv. Më tutje, Lushtaku ia ka

serbizuar mbiemrin Kurtit, duke e quajtur "Kurtoviq", ndërkohë e ka ftuar ta aktivizojë drejtësinë mbi të nëse ka dyshime për vepra penale. "Kurtoviqi e ka pushtetin. Nëse konsideron që jemi hajna, le të veprojë drejtësinë. E ftoj Kurtoviqin dhe sejmënët e tij, le të urdhërojnë... gjykatën e kanë, prokurorinë e kanë. Kam prituri nga kjo qeveri që minimalisht t'i ndihmojë ata që janë në Hagë, e ky publikon këso video që janë të çuditshme", ka thënë Lushtaku, duke shtuar se Kurti ka dështuar në qeverisje.



Qeveria Kurti sjell pakënaqësi të mëdha për mosekzekutimin e pagave për mësimdhënësit

Avokati i Popullit, kryetarë të komunave, Këshilli i Prindërve të Kosovës, shoqëria civile, gjashtë deputetë të grupit parlamentar të LV-së, partitë opozitare, kanë shprehur pakënaqësi të mëdha për mosekzekutimin e pagave për mësimdhënësit për muajin shtator. Avokati i Popullit, Naim Qelaj, ka thënë se mosekzekutimi i pagave të mësimdhënësve do ta rrezikojë seriozisht mirëqenien sociale për mësimdhënësit dhe për familjet e tyre

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 4 TETOR - Avokati i Popullit, Naim Qelaj, ka bërë me dije të martën se është duke e ndjekur me shqetësim situatën lidhur me mosekzekutimin e pagave për mësimdhënësit të cilët deri para pak ditësh ishin në grevë.

Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit rithekson rëndësinë që ka ruajtja e kohezionit social në periudhën kur sapo kemi dalë nga një situatë e vështirë për shkak të mosfillimit në kohë të vitit të ri shkollor. "Mosekzekutimi i pagave të mësimdhënësve do ta rrezikojë seriozisht mirëqenien sociale për

mësimdhënësit dhe për familjet e tyre, në një gjendje edhe ashtu të brishtë, e kjo nuk do t'i kontribuojë dialogut social dhe përmirësimit të situatës së krijuar", thuhet në deklaratën e tij. Gjithashtu, Avokati i Popullit rikujton përgjegjësinë kushtetuese e ligjore të qeverisë dhe detyrimin pozitiv që ka shteti për respektimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut për sigurimin e paqes sociale në vend si dhe për domosdoshmërinë që autoritetet ta garantojnë përdorimin e standardeve të njëjta sa i përket grevës, për situata të ngjashme, duke i trajtuar të gjithë në mënyrë të barabartë. "Në këtë periudhë është e rëndësishme që qeveria,

me secilin veprim dhe masë që merr, të kontribuojë në zbutjen e krizës së rëndë të krijuar si rezultat i kësaj gjendjeje. Prandaj Avokati i Popullit edhe publikisht përmes kësaj komunikate i bën thirrje Qeverisë së Republikës së Kosovës që të reflektojë dhe ta gjejë një zgjidhje për të dalë nga kjo situatë", është theksuar në deklaratën e Avokati i Popullit, Naim Qelaj.

Këshilli i Prindërve i Kosovës ka bërë thirrje për normalitet. Përmes një postimi në "Facebook", pjesëtarë të Këshillit kanë thënë se, ndonëse nuk janë pajtuar asnjëherë me grevën, ata solidarizohen me mësimdhënësit "kur trajtohen padrejtësisht e jashtë çdo norme, me interpretim të njëanshëm ligjor dhe jashtë të gjitha praktikave të deritanishme". "Le t'i trajtojmë të tjerët siç duam të trajtohen fëmijët tanë", është thënë në thirrjen e Këshillit të Prindërve.

Ndërkaq ka shkuar në gjashtë numri i deputetëve të Vetëvendosjes, që kanë dalë kundër vendimit të qeverisë Kurti për mosekzekutimin e pagave për

mësimdhënësit grevistë. Pas dy deputetëve të Listës Guxo, Jeta Statovci e Haxhi Avdyli, që dolën të hënën kundër vendimit të qeverisë, të martën edhe katër deputetë të LV-së e kundërshtuan këtë vendim. Deputeti Fatmir Humolli ka theksuar se ai është kundër këtij vendimi. Pas tij, edhe deputeti Eman Rrahmani ka kërkuar të dalin pagat për grevistët.

Edhe deputeti tjetër i LV-së, Alban Bajrami, ka kërkuar që qeveria ta bëjë ekzekutimin e pagave si dhe të gjejë alternativë për kompensimin e orëve të humbura gjatë mbajtjes së grevës. Kundër partisë së tij, përpos disave që tashmë janë deklaruar, sa iu përket pagave, ka dalë edhe deputeti Visar Korenica.

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka theksuar se zhvillimet politike ekonomike sociale në Kosovë nuk kanë qenë asnjëherë më të dëmshme për vendin sesa sot. "Çdo vendim i qeverisë është orientuar kundër interesave të qytetarëve e shembulli më eklatant i kësaj është penalizmi i rreth 20 mijë

mësimdhënësve duke mos ua dhënë pagat. Aleanca është e shqetësuar me këtë gjendje të pashpresë e cila kërkon zgjidhje urgjente. Në këtë frymë sot kishim një diskutim pune për dëshimet e kësaj qeverie dhe për zgjidhjet e duhura që të përfshihen në planin qeverisës të Aleancës, të cilin do ta diskutojmë nesër në kryesinë e partisë", ka deklaruar Haradinaj. Drejtori i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), Ehat Miftaraj, ka vlerësuar se mosekzekutimi i pagave për grevistët është në kundërshtim me ligjin. Sipas juristit Miftaraj, Ligji për Grevat duhet të interpretohet në pajtim me standardet ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë, duke siguruar të drejtën e grevës.

Në një prononcim për "Ekonomia Online", Miftaraj ka thënë se është arbitrare që të pezullohen pagat për grevistëve. "Pezullimi i pagave është i kundërligjshëm, pasi Ligji për Grevat, në nenin 1, përcakton që qëllimi i këtij ligji ka për qëllim t'ua ofrojë të drejtat dhe beneficinet e grevistëve, si dhe këto të drejta duhet të interpretohen në pajtim me

Truss i shkruan Kurtit: Mbretëria e Bashkuar dhe Kosova janë në një linjë

PRISHTINË, 4 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pranuar letër nga kryeministrja e Mbretërisë së Bashkuar, Liz Truss, si përgjigje në urimin e dërguar me rastin e emërimit të saj. Kryeministrja Truss ka

falënderuar kryeministrin Kurti për letër urimin e dërguar më 6 shtator si dhe për ngushëllimet pas ndarjes nga jeta të Madhërisë së saj të ndjerë, Mbretëreshës Elizabetë II. Ajo, po ashtu, ka shprehur

kënaqësinë për dy takimet me Kurtin gjatë këtij viti, kur ishte sekretare e jashtme. "Mbretëria e Bashkuar dhe Kosova janë qartazi në një linjë në shumë fusha dhe ka mundësi të mëdha që dy vendet tona të punojnë së

bashku edhe për më së afërmi", ka shkruar kryeministrja Truss, duke shtuar se: "Mbretëria e Bashkuar ishte krenare për ndihmën dhënë Kosovës për sigurimin e pavarësisë së saj dhe që ishte vendi i parë që njohu

formalisht pavarësinë e saj në vitin 2008. Do të vazhdoj ta përcjell Kosovën me interes të madh ndërsa ecni përpara me procesin tuaj të reformës", ka theksuar kryeministrja Truss në përmbyllje të letrës.



standardet ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë. Standardet ndërkombëtare në këtë rast janë opinionet ligjore praktikat më të mira të Organizatës Ndërkombëtare të Punës", ka thënë Miftaraj.

Viti i ri shkollor ka nisur zyrtarisht të hënën në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në Kosovë. Fillimi i mësimi ka ndodhur me një vonesë prej një muaji si rezultat i një greve të mësimdhënësve e cila është pezulluar deri në janar. Por ky fillim i procesit mësimor nuk shkoi si duhet pasi qeveria nuk ua dha pagat për muajin shtator grevistëve të arsimit.

Kryetari i Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBASHK), Rrahman Jasharaj, ka paralajmëruar situatë të tensionuar nëse ekzekutimi i pagave nuk bëhet deri më 5 tetor. Greva në arsim dhe në administratën publike, në nivelin lokal dhe qendror, ka nisur më 25 gusht të këtij viti. Greva është pezulluar pas votimit të anëtarësive të sindikalistëve.

Sindikalistët kanë mbajtur grevën me kërkesë kyçe për ndarje të 100 eurove për punëtorë, për çdo muaj, deri në hyrjen në fuqi të

Ligjit për Paga.

Qeveria, në anën tjetër, ka publikuar një pako për ndihmë për shkak të rritjes së inflacionit - dhe në të janë ndarë edhe nga 50 euro për të gjithë punëtorët e sektorit publik.

Qeveria së fundmi ka hartuar Projektligjin për Paga dhe i njëjti është në procedura të konsultimeve publike. Ai më pas duhet të miratohet në Qeveri dhe Kuvend, më pas të publikohet në Gazetën Zyrtare. Tetë muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare, ky legjislacion pritet të hyjë në fuqi.

Mosdhënia e pagave, Nagavci fajëson komunitat

Ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit në Kosovë (MASHTI), Arbërie Nagavci, ka thënë të martën se komunitat nuk i kanë raportuar Ministrisë së Financave listat e punëtorëve për muajin shtator. Sipas saj, komunitat janë përgjegjëse për organizimin e arsimit parauniversitar dhe janë punëdhënëse të këtyre institucioneve. "Ndonëse komunitat janë përgjegjëse për organizimin e arsimit parauniversitar, janë

punëdhënëse dhe e kanë obligim të raportojnë çdo muaj në Departamentin e Thesarit në Ministri të Financave, një gjë të tillë nuk e kanë bërë. Me kërkesë të ministrit të financave, Hekuran Murati, i kemi dërguar ato të dhëna që i kemi pasur të inspektorëve dhe zyrtarëve të MASHTI-t nga vizitat gjatë muajit shtator, në shkollë e çerdhe, me qëllim të realizimit të pagave për ta. Ata që janë dëmtuar më së shumti nga greva e organizuar nga SBASHK-u janë nxënësit, fëmijët tanë", ka thënë Nagavci.

Ajo ka theksuar se më shumë se një vit kanë zhvilluar dhjetëra takime me kryesinë e SBASHK-ut, të cilët thotë se kanë lutur të mos marrin hapa të pamenduar. "Kemi adresuar shumë shqetësime të mësimdhënësve, kemi miratuar politika të reja e rritur buxhetin për arsim. Kemi diskutuar me kryesinë e SBASHK-ut se a do t'i kompensojë sindikata pagat e mësuesve ashtu siç ndodh në shumicën e vendeve të tjera dhe me qëllim ligji ndalon kompensimin për punën e pakryer. Asnjë vëmendje e kujdes në këtë drejtim, përkundrazi një muaj grevë, shumë dëme për fëmijët, asnjë kujdes nga

punëdhënësit, shumë zhurmë nga ata që kanë përgjegjësi për gjendjen në të cilën ndodhet arsimi. Dhjetëra takime me vullnet të njëanshëm, me përpjekje të njëanshme për rezultate të synuara që të jenë të përbashkëta", ka deklaruar Nagavci.

Ajo ka thënë se ligji duhet të respektohet në tërësi. "Ne kemi premtuar për këtë dhe premtimet tona i mbajmë. Kemi marrë mandatin për t'i hartuar politikat e për t'i realizuar ato dhe s'do të ndalemi. Sot publikojmë kalendarin e rishikuar për vitin shkollor për 22 ditë të humbura të mësimi. Rezultatet në arsim do t'i përmirësojmë. Bashkëpunimi e dialogu social do të vazhdojë, me parime e korrektësi, në interesin më të mirë të fëmijëve. Kompensim do të ketë. Kompensim për punën e bërë", është shprehur ministrja Nagavci. Ndaj deklaratës së Nagavci ka reaguar kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, i cili ka thënë se kjo ministre është e paafte. "Fatkeqësisht, tashmë janë bërë të zakonshme huqjet që po i bën kjo qeveri, e pritshme për mua që kësaj radhe ia huq ministrja e Arsimit, e Shkencës

dhe e Teknologjisë, znj. Arbërie Nagavci, e cila paska deklaruar që 'komunitat' qenkan fajtorë për pagat e mësimdhënësve, e zakonshme për një praktikante të paafte që udhëheq këtë ministri. Bazuar në kompetencat ligjore, çështja e pagave është kompetencë e komunës e, bazuar në këtë kompetencë, komunitat i kanë proceduar pagat sipas ligjit. E nderuara ministere e paafte, sa për dijeninë tuaj, është thesari i shtetit - Ministria për Buxhet dhe Financa - që e ka ndaluar ekzekutimin e këtyre pagave. Këtë fakt është dashur ta dini", ka shkruar në "Facebook" Ramosaj. Ndaj deklaratës së ministres Nagavci, ka reaguar kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci. Ai ka thënë se komuna që e udhëheq ai e ka dërguar listën e pagave për punëtorët e arsimit, sipas afatit ligjor. Sipas Lladrovci, Ministria e Financave ka vepruar jashtëligjshëm me ndalimin e pagesave për mësimdhënës. "Një dëshmi tjetër që është vepruar në kundërshtim me ligjin, është edhe fakti se edhe mësimdhënësve që janë në pushim të lehonisë, apo pushim mjekësor, u është ndaluar paga", ka thënë Lladrovci.

Vazhdon puna në infrastrukturën rrugore të komunës së Prizrenit


PRIZREN, 4 TETOR - Në vazhden e punimeve të shumta infrastrukturore, në rrugë të ndryshme, lagje e fshatra, në komunën e Prizrenit, kryetari Shaqir Totaj, së bashku me drejtorin e Shërbimeve Publike, Çelë Lamaj, shikuan nga afër punimet që po zhvillohen në rrugën "Rugova" në lagjen mbi spital. Po në këtë lagje së shpejti fillon asfaltimi në rrugën "Norë Kelmendi" pasi të bëhet nivelizimi

i pusetave. Këto projekte janë shumë të rëndësishme për rregullimin e infrastrukturës për banorët e zonës duke e lehtësuar jetën e tyre pas një periudhe të gjatë me vështirësi. Gjatë muajit tetor do të punohet për rregullimin e infrastrukturës në shumë lagje brenda qytetit dhe në segmentet që lidhin të gjitha zonat e komunës së Prizrenit, në përgjithësi, me ç'rast do të lehtësohet jeta e të gjithëve.



Ndriçohet Sahat Kulla në Prishtinë

PRISHTINË, 4 TETOR - Objekti i Sahat Kullës në Prishtinë është ndriçuar pasi ai i është nënshtruar një restaurimi disamujor. Tani dritat në këtë objekt do të jenë shumëngjyrëshe. Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka ndezur dritat në Sahat Kullë, që është një prej monumenteve të trashëgimisë kulturore të kryeqytetit të Kosovës. Sahat Kulla është ndërtuar në shekullin 19 dhe ndërhyrjet e fundit janë bërë me ndihmën e Bashkimit Evropian dhe UNDP-së.



Fillon zhdoganimi në Portin e Durrësit për mallrat me destinacion Kosovën



EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

DURRËS, 4 TETOR - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve të Kosovës, Hekuran Murati dhe ministrja e Financave dhe Ekonomisë së Shqipërisë, Delina Ibrahimaj, kanë vizituar të martën zyrat e Doganës së Kosovës në portin e Durrësit. Vizita është bërë me rastin e fillimit të zhdoganimit të plotë në portet e Durrësit për mallrat me destinacion Republikën e Kosovës.

Zhdoganimi i mallrave në portet e Durrësit i mundëson ekonomisë së Kosovës që praktikisht të ketë qasje në det, duke lehtësuar

kështu depërtimin e bizneseve vendore në tregjet ndërkombëtare. "Me modalitetet e tanishme të funksionimit të zhdoganimit në portet e Durrësit, do t'i ulim kostot për bizneset dhe konsumatorët në rreth dy milionë euro, kurse përmirësimi i kohës së zhdoganimit do të reflektohet në krijimin e kushteve optimale për tërheqjen e investimeve të huaja në vend", ka thënë ministri Hekuran Murati.

Ndërkaq ministrja Delina Ibrahimaj ka thënë se zhdoganimi i mallrave me destinacion Kosovën në portin e Durrësit është vetëm hapi i radhës në marrëdhëniet tona tregtare, duke theksuar edhe

njëherë angazhimin e qeverisë shqiptare për thellimin e bashkëpunimit ndërshtetëror.

Dogana e Kosovës është vendosur në portin e Durrësit që nga viti 2019, mirëpo deri më tani është bërë vetëm regjistrimi i hyrjeve për mallrat që kanë pasur destinim Republikën e Kosovës, pa pasur ndonjë ndikim në uljen e koston apo kohës për biznese e konsumatorë.

Në mbledhjen e fundit në mes të dy qeverive, të mbajtur në qershor të këtij viti, është nënshkruar marrëveshja për analizimin e bashkimit të mundshëm doganor, i cili shënon integrimin tregtar në mes të dy ekonomive.

Vazhdojnë punimet në rregullimin e objektit të QKMF-së në Malishevë

MALISHEVË, 4 TETOR - Punimet në rregullimin e oborrit, garazheve dhe meremetimit, përkatësisht izolimit të objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Malishevë, janë duke vazhduar sipas dinamikës së paraparë. Për këtë qëllim, të martën drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Avdi Morina, e ka vizituar QKMF-në, përkatësisht i ka parë nga afër punimet që janë duke u

realizuar.

Drejtori Morina është pritur nga drejtori i QKMF-së në Malishevë "Dr. Shpëtim Robaj", Afrim Krasniqi, si dhe është njoftuar nga punëkryesi me ecurinë e zbatimit të planit dinamik dhe të projektit në tërësi. "Punimet janë duke u zhvilluar sipas planifikimit të paraparë dhe shumë shpejt do të kemi një objekt të izoluar mirë, me një hapësirë

më të përshtatshme, me garazhe për vetura, oborr me parking të mjaftueshëm dhe të rregulluar për qarkullim pa pengesa dhe që lehtëson edhe ofrimin e shërbimeve më të shpejta", ka thënë Morina.

Ai, gjithashtu, ka bërë me dije se ky projekt është edhe një prej projekteve të shumta që janë duke u realizuar dhe financohet nga buxheti i komunës së Malishevës.



QKUK-ja ua "merr" pacientët spitaleve rajonale



PRISHTINË, 4 TETOR - Spitalet rajonale të Kosovës, ndonëse me aparatura të sofistikuar dhe staf profesional, shpesh nuk i bindin pacientët se ofrojnë shërbime adekuata.

Janë shtatë spitale të tilla që mbulojnë secilën zonë të vendit, por barra kryesore duket se bie mbi Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Aty qarkullojnë mijëra pacientë në ditë, që marrin shërbime nga më të ndryshmet: nga kontrolli rutinor deri tek operacioni. "Kam ardhur në Prishtinë [në QKUK] se mendoj se është më mirë", thotë Fatosi, një burrë në të 50-tat.

Paraditen e 3 tetorit ai kishte udhëtuar nga Klina - mbi 60 kilometra larg Prishtinës - për të bërë një termin për rrezatim të mushkërive, apo skanim CT, në Klinikën e Radiologjisë në QKUK.

Rajonin ku jeton ai, e mbulon spitali i përgjithshëm i Pejës, por Fatosi thotë të ketë dëgjuar se "në Prishtinë bëhet më mirë".

Duke folur për Radion Evropa e Lirë, ai tregon se ka arritur ta bëjë terminin vetëm pak ditë pasi "mjeku në Pejë e ka udhëzuar të bëjë CT".

Fatin e tij nuk e kanë shumë

pacientë të tjerë që për këtë shërbim duhet të presin me muaj. Radio Evropa e Lirë pa më 3 tetor listën e terminëve në Radiologjinë e QKUK-së dhe i fundit për CT mban datën 30 dhjetor 2022.

Mbi 680 raste të referuara nga Peja

Nga spitali i përgjithshëm i Pejës thonë se në QKUK referohen vetëm ato raste që nuk mund t'i kryejnë për shkak të urgjencës.

Roza Kola-Hajdari, drejtoreshë e Radiologjisë në këtë spital, thotë për Radion Evropa e Lirë se reparti funksionon me dy radiologë dhe se ndodh që pacientëve u duhet të presin deri në një muaj për një skanim CT. "Ka pacientë që nuk janë të kënaqur me listën e pritjes dhe shkojnë vetë në Prishtinë", thotë ajo. Përveç Pejës, ky spital mbulon edhe komunat: Istog, Klinë, Deçan dhe Junik. Ka aparatura për shërbime të ndryshme - disa edhe të papërdorura fare, për shkak të mungesës së stafit përkatës.

Sipas drejtorisë së spitalit, numri i vizitave të mjeku specialist në këtë institucion kalon 15 000

brenda muajit. Nga kjo drejtori bëjnë me dije për Radion Evropa e Lirë se nga 1 janari i këtij viti deri më 28 shtator në QKUK janë transferuar 688 raste. "Afër 60 % e këtyre transferimeve u përkasin problemeve me zemër dhe aksidenteve me lëndime të rënda", thonë nga drejtorja e spitalit, duke sqaruar se për raste të tilla ata nuk mund të ofrojnë shërbime. Nga kjo drejtori thonë se edhe mungesa e stafit për të operuar me aparatura të caktuara çon shpesh te referimet për në QKUK.

Referime edhe nga Gjilani dhe Gjakova

Më 3 tetor REL bisedoi edhe me Zymer Jerliun nga Komuna e Gjilanit që donte të bënte një CT në Klinikën e Radiologjisë në QKUK. "Mjeku më ka propozuar kështu, se unë nuk kam asnjë vërejtje në spitalin e Gjilanit", thotë ky 67-vjeçar.

Drejtori i spitalit në Gjilan, Arsim Emini, pranon se ka raste që nuk do të duhej të referoheshin në QKUK, por thotë se "problemet në këtë spital janë të natyrave të ndryshme". "Është edhe mungesa e përgjegjësive, edhe

neglizhenca", thotë Emini, pa dhënë detaje se cilat raste referohen më shumë.

Spitali i Gjilanit ofron shërbime për atë që njihet si rajon i Anamoravës. "Ka mundësi që pacientët nga Gjilani, për CT, shkojnë direkt në Prishtinë, ka mundësi që gjejnë lidhje dhe shkojnë menjëherë, se e vërteta është se këtu ka listë të pritjes [për këtë shërbim] që shkon deri në dy muaj", thotë Emini për Radion Evropa e Lirë. Ky spital ka të punësuar katër radiologë, që janë të thirrur për të lexuar skanime CT.

Mbi 120 kilometra larg Gjilanit gjendet Gjakova, e cila, po ashtu, ka spitalin rajonal, që mbulon disa komuna në pjesën jugore dhe perëndimore të Kosovës. Në këtë spital ankohen për mungesë të radiologëve. Aty punojnë tre specialistë të tillë, ndërsa thonë se do të duheshin edhe tre të tjerë. "Ka qytetarë të pakënaqur dhe shkojnë në mënyrë individuale [në QKUK] dhe kërkojnë mendime të tjera", thotë për Radion Evropa e Lirë drejtori i spitalit, Jeton Zarari. "Rastet e rënda i referojmë. Rastet e mesme i trajtojmë këtu, i mjekojmë këtu, por ka pacientë që shkojnë vetë", thekson ai.

Dyndje pacientësh nga të gjitha anët e Kosovës dhe lista të gjata të pritjes, REL ka parë pothuajse në çdo klinikë të QKUK-së.

Nga udhëheqja e këtij institucioni thonë se nuk ka asnjë rregullore të shkruar për referimin e pacientëve nga spitalet rajonale në QKUK.

Referimet, sipas tyre, bëhen pas vlerësimeve nga spitalet, por se ka raste kur pacientët, pavarësisht se nga cila komunë janë, vendosin vetë të drejtohen në QKUK dhe QKUK-ja nuk i refuzon. Ata pranojnë se ka raste kur pacientët që mund të trajtohen edhe në shtëpi shëndeti, referohen në Emergjencën e QKUK-së.

Nga Ministria e Shëndetësisë e Kosovës thonë se janë duke punuar që të krijohen kushte më të mira si për pacientët ashtu edhe për stafin shëndetësor në spitalet rajonale. "Komisioni Ekzekutiv është duke ndërmarrë hapa për përmirësime të cilësisë së shërbimeve, duke përfshirë edhe komoditetin e punëtorëve shëndetësorë", thotë për REL-in zëvendësministri i Shëndetësisë, Arsim Berisha, duke mos dhënë më shumë detaje rreth këtyre hapave.

Qeveria e Kosovës ka njoftuar muajin e kaluar, se ka formuar Komisionin Ekzekutiv për Shëndetësi, përgjegjësitë e të cilit, siç është thënë, do ta përfshijnë zhvillimin e sektorit publik të shëndetësisë.

Ky sektor, prej vitesh, përballet me kushte jo të mira të punës dhe largim të stafit shëndetësor. Sipas të dhënave të Odës së Mjekëve të Kosovës, këtë vit nga QKUK-ja dhe spitalet rajonale publike janë larguar mbi 60 mjekë.

Në mungesë të mjekëve, por edhe të kushteve adekuata, pritet për shërbime të caktuara në QKUK zgjasin me muaj apo vite.

Pacientët shpesh ankohen edhe për mungesë të barnave nga lista esenciale, të cilat pastaj duhet t'i sigurojnë vetë. Për shkak të numrit të vogël edhe të infermierëve, dhomat e pacientëve janë shpesh të mbushura me familjarë që i shoqërojnë ata. Përveç në Pejë, Gjilan e Gjakovë, Kosova ka spitale rajonale edhe në Prizren, Mitrovicë, Ferizaj e Vushtrri.

Konjufca pret mbështetjen e Francës për liberalizimin e vizave


PRISHTINË, 4 TETOR - Kryetari i Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të martën në takim ambasadorin e ri të Francës në Kosovë, Olivier Guerot, me ç'rast e ka uruar për marrjen e detyrës.

Konjufca e ka falënderuar ambasadorin Guerot për përkrahjen të cilën Franca e ka ofruar për Republikën e

Kosovës në të gjitha proceset e shtetndërtimit, zhvillimit dhe rrugëtimit drejt integriteteve evropiane.

Kryetari i Kuvendit ka theksuar se presin nga shteti francez mbështetjen e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës meqë janë përmbushur tashmë të gjitha kriteret e kërkuara. Po ashtu, edhe përkrahjen për

anëtarësim në Këshillin e Evropës, BE, NATO dhe organizata të tjera ndërkombëtare. Kryetari Konjufca dhe ambasadori Guerot konfirman përkushtimin dhe gatishmërinë për thellim të mëtutjeshëm të bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve në sfera të interesit të përbashkët.



Pushtimi rus i Ukrainës pengon rimëkëmbjen pas pandemisë të ekonomive të reja të Evropës dhe Azisë Qendrore

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 4 TETOR - Lufta që po zhvillohet në Ukrainë ka zbehur perspektivat e rimëkëmbjes post-pandemi për ekonomitë e reja dhe në zhvillim të rajonit të Evropës dhe Azisë Qendrore, thuhet në Përditësimin Ekonomik të Bankës Botërore për rajonin, të publikuar të martën.

Aktiviteti ekonomik do të mbetet në nivele shumë të ulëta dhe përgjatë vitit të ardhshëm, me pritshmëri për një rritje minimale prej 0.3-përqindësh në vitin 2023 për shkak se goditet nga rritja e çmimit të energjisë do të vijojnë të sjellin pasoja në rajon. Megjithatë, rajoni i ka përballuar deri më tani vështirësitë e shkaktuara nga pushtimi rus i Ukrainës më mirë nga sa ishte parashikuar më parë. Prodhimi rajonal pritet të tkurret me 0.2 për qind këtë vit, duke reflektuar rritje më të forta se pritshmëritë për disa nga ekonomitë më të mëdha të rajonit dhe zgjatjen e kujdesshme të zbatimit të programeve stimuluese që qeveritë e disa vendeve ndërmorën gjatë periudhës së pandemisë.

Ekonomia e Ukrainës aktualisht parashikohet të tkurret me 35 për qind këtë vit

si rezultat i dëmtimit të aktivitetit ekonomik nga shkatërrimi i kapaciteteve prodhuese, dëmtimit të tokës bujqësore dhe zvogëlimit të ofertës së punës pasi më shumë se 14 milionë njerëz mendohet të jenë shpërngulur nga shtëpitë e tyre.

Sipas vlerësimeve të fundit të Bankës Botërore, nevojat për rimëkëmbje dhe rindërtim në mbrojtjen sociale, sektorët prodhues dhe të infrastrukturës arrijnë të paktën në 349 miliardë dollarë, shifër kjo 1.5 herë më e lartë se madhësia e ekonomisë para-lufte të Ukrainës në vitin 2021. “Pushtimi rus i Ukrainës ka shkaktuar një nga krizat më të mëdha të shpërnguljes së njerëzve dhe një bilanc të rëndë për sa iu përket jetëve njerëzore dhe situatës ekonomike”, ka thënë Anna Bjerde, zëvendës-presidente e Bankës Botërore për rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore. “Në kushtet e vazhdimtë të një lufte të panevojshme, Ukraina vijon të ketë nevojë për mbështetje të madhe financiare si dhe për projekte rimëkëmbjeje dhe rindërtimi që mund të ndërmerren me shpejtësi”, ka theksuar Bjerde. Lufta po vijon ta dobësojë ekonominë globale nëpërmjet ndërprerjeve të konsiderueshme në tregti dhe



goditjeve të çmimeve të ushqimeve dhe karburanteve dhe të gjitha së bashku po kontribuojnë në rritjen e inflacionit dhe shtrëngimit pasues të kushteve të financimit në tregjet botërore. Aktiviteti ekonomik në eurozonë, që është partneri më i madh ekonomik për tregjet e reja dhe ekonomitë në zhvillim (EMDE) të rajonit të Evropës dhe Azinë Qendrore, është përkeqësuar ndjeshëm në gjysmën e dytë të vitit 2022 për

shkak të problemeve në zinxhirët e furnizimit, rritjes së tensioneve financiare dhe rënies së besimit të konsumatorëve dhe biznesit. Megjithatë, pasojat më të rënda nga pushtimi janë rritja e çmimeve të energjisë si rezultat i reduktimeve të mëdha në furnizimin me energji nga Rusia.

Rishikimi me ulje i normave të parashikuara të rritjes për vitin 2023 prekin një pjesë të madhe të tregjeve të reja dhe ekonomive

në zhvillim të Evropës dhe Azisë Qendrore për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë që dominon perspektivën rajonale. Zgjatja apo shtimi i mëtejshëm i luftës mund të shkaktojë dëme ekonomike dhe mjedisore edhe më të mëdha si dhe rrit mundësinë për fragmentizim të tregtisë dhe investimeve ndërkombëtare. Rreziku i stresit financiar mbetet gjithashtu i lartë, duke pasur parasysh nivelet e larta të borxhit dhe inflacionit.

Kosova dhe Zvicra shprehin përkushtim për finalizimin sa më të shpejtë të marrëveshjes EFTA

PRISHTINË, 4 TETOR - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ka pritur në takim një delegacion të parlamentit zviceran që ka përcjellë bisedimet e Republikës së Kosovës me vendet e EFTA-s, të përbërë nga anëtarë i Këshillit Kombëtar të Zvicrës, Hans-Peter Portmann, anëtarët e Këshillit të Shteteve të Zvicrës, Benedikt Wurth dhe Hannes Germann, zëvendëssekretarja e delegacionit, Myriam Bertsch, si dhe ambasadori i Zvicrës në Kosovë, Thomas Kolly dhe zëvendësambasadorja Pauline Menthonnex-Gacaferri.

Kosova dhe Zvicra janë të përkushtuara për finalizimin sa më të shpejtë të marrëveshjes EFTA (Shoqata Evropiane e Tregtisë së Lirë), e cila ka rëndësi të madhe për Kosovën, pasi shkëmbimet tregtare me vendet e EFTA-s, veçanërisht me Zvicrën, janë vazhdimisht në rritje dhe kanë një bilanc të



dukshëm pozitiv tregtar. EFTA si organizatë rajonale tregtare dhe zonë e tregtisë së lirë përbëhet nga katër shtete evropiane: Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Zvicra.

Ministria Hajdari ka çmuar raportet e mira dhe miqësore në mes të Kosovës dhe Zvicrës,

duke i njoftuar mysafirët për prioritetet e qeverisjes së tanishme “punësim dhe drejtësi”, për progresin e shtetit tonë në raportet ndërkombëtare, për treguesit në rritje të sundimit të rendit dhe ligjit, demokracisë dhe zhvillimit ekonomik.

Delegacioni zviceran u njoftua

më gjerësisht për politikën industriale, konkretisht për përparësitë konkurruese të sektorëve industrialë, me shembuj suksesi në ‘business process outsourcing’, për shkathtësitë e të rinjve tanë në inovacion dhe ndërmarrësi, si dhe për mundësitë e shtimit të bashkëpunimeve ekonomike

në fushat me interes reciprok mes dy vendeve përmes nënshkrimit të marrëveshjes EFTA.

Qeveria e Kosovës synon ta zgjerojë bashkëpunimin me vendet e EFTA-s në fusha me rëndësi të veçantë për t'i zgjeruar marrëdhëniet e tyre tregtare, siç janë flukset e investimeve, duke përfshirë transferimin e njohurisë dhe teknologjisë, politikën dhe ligjin e konkurrencës, prokurimin publik, tregtinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm, si dhe çështje dhe politika të tjera të lidhura me tregtinë, duke përfshirë tregtinë e mallrave dhe shërbimeve, bashkëpunimin doganor dhe të drejtat e pronësisë intelektuale.

Republika e Kosovës ka lansuar negociatat me vendet EFTA gjatë muajit qershor 2022, gjersa ka përfunduar raundin e parë të negociatave në fund të muajit gusht 2022.

GJUHET E HUAJA | Një Babel brenda në kokën tonë

Ka nga ata që janë në gjendje të komunikojnë në 18 gjuhë të huaja dhe nga ata që flasin rrjedhshëm të paktën dy të tilla. Të rinj dhe udhëtarë të përjetshëm janë duke rishkruajtur rregullat e komunikimit botëror. Eshtë e kundërta e Kullës së Babelit, ku fjalët kryqëzohen dhe krijohen

Janë të etur për gjuhë të huaja, ashtu sikurse për kontakte dhe lidhje. Nëse nuk flet je jashtë, dhe nuk ka përkthim në Google që mund të të ndihmojë. Që nga hiperpoliglotët që janë në gjendje të flasin edhe 18 gjuhë të ndryshme, tek minipoliglotët që njohin në mënyrë të përsosur dy të tilla, bota e të rinjve dhe ajo e shumë të rinjve, por edhe e migrantëve, punëtorëve dhe atyre që bredhin globin, është duke rishkruajtur rregullat e komunikimit botëror. Eshtë, si të thuash, e kundërta e Kullës së Babelit, ku gjuhët kryqëzohen, krijohen, por në fund rezultati është që kuptohen gjithnjë e më shumë. Libri i Michael Erard, "Babel no more", rrëfen historitë e disa politglotëve autodidaktë të jashtëzakonshëm, në gjendje të flasin dhe kuptojnë nga 15 deri 18 gjuhë të huaja.

Duke lënë mënjanë përjashtimet, multilinguizmi duket se është bërë një nevojë parësore e brezave të rinj: 67% e polakëve dhe 64% e francezëve, kundrejt 48% të gjermanëve dhe 43% të italianëve pranojnë se flasin mirë dy gjuhë të tjera, përveç gjuhës së tyre. Dhe këtu spikasin në Itali, ashtu si gjetkë, ata që quhen "2G", apo imigrantët e brezit të dytë, që kanë lindur në Itali apo që kanë shkuar atje që të vegjël, por gjithmonë të ekspozuar ndaj dy apo tre gjuhëve. Një përzierje që sot regjistron 7 mijë gjuhë të ndryshme por që është e destinuar të dallohet në gjysmëshekullin e ardhshëm, nëse është e vërtetë që 90 përqind e gjuhëve flitet "vetëm" nga grupe më pak se 100 mijë vetë dhe 2500 janë në rrezik zhdukjeje. Por ekzistojnë karakteristika kulturore, mjedisore, fizike dhe neurologjike që i lejojnë disa të arrijnë nivele të jashtëzakonshëm, ndërkohë që të tjerë e kalojnë gjithë jetën duke u përpjekur të arrijnë thjeshtë një "anglishte skolasike"?

Në librin e tij, Michael Erard flet shprehimisht për një "hardware" neurologjik të veçantë, të cilin e kanë poliglotët që ai ka intervistuar, me një fjalë një "dhunti natyrore" bashkë me një jetë vagabonde dhe me zanate që i kanë detyruar të mësojnë gjithmonë gjuhë të reja. Andrea Moro, profesor i linguistikës së përgjithshme në Shkollën e Lartë Universitare Issur në Pavia, e zgjeron temën dhe

pohon që "mund të shpjegojmë me kërkime të saktë shkencorë se sa gjuhë mund të mësojë truri i njeriut, cilat janë ato që i metabolizon vërtetë dhe ato që kapen në mënyrë të thjeshtë në kujtesën tonë".


Një tezë e hedhur në librin e tij "Kufijtë e Babelit" në të cilën nuk hamendëson aspak për një fund të "kullës" së idiomave siç e përshkruan Gjeneza, por i gjen kufijtë. Duke saktësuar se gjithçka nis në fëmijërinë e hershme dhe përfundon në kohën e pubertetit, një tregues ky që nuk lë aspak dyshime se sa duhet investuar në nivel skolasik për studimin e gjuhëve.

Ndërkohë, siç nënvizon Linda Rossi Holden, docente e didaktikës në gjuhën angleze në Universitetin e Modenës, "sot në Itali, pavarësisht nevojës për njohje të gjuhëve të huaja, niveli i mësimit mbetet i ulët dhe gjuhët arrijnë t'i mësojnë vetëm të rinjtë që mbështeten ekonomikisht nga familjet".

Dhe duhet mësuar të deshifrohen siglat e niveleve linguistikë europiane për të kuptuar se sa i madh është problemi, për shembull i të rinjve italianë, që në 44% të rasteve paraqiten në Universitet apo më keq akoma, në botën e punës me një anglishte të thjeshtë skolasike.

Andrea Moro shpjegon: "Deri në pubertet, gjuhët mësohen në mënyrë spontane, kur kalohet kjo periudhë truri e humbet atë plasticitet të jashtëzakonshëm dhe duhen përdorur instrumenta të tjerë, për shembull kujtesa. Kjo nuk do të thotë që kur kalohet moshja e rinisë nuk mund të mësohen më gjuhë, por proceset neurologjike bëhen më pak automatikë e të lehtë. Dhe një prej arsyeve përse italianët nuk i flasin mirë gjuhët e huaja është se këto nuk mësohen që në fëmijëri".

Por Moro shkon edhe më tej: "Në librin Kufijtë e Babelit ai që unë rrefej është një eksperiment i kryer për të kuptuar se si truri i mëson gjuhët. Kemi vënë re, përmes rezonancës magnetike, se cilat zona aktivizoheshin në bazë të stimujve gjuhësorë. Dhe kemi parë që ndërkohë që me fjalë dhe fraza të ndërtuara në mënyrë tradicionale, përmes sintaksës, truri përgjigjet duke magazinuar dhe metabolizuar përmbajtjen,



ndërsa nëse ofronim një gjuhë të sajuar, absurde, reagimi ishte i ndryshëm, sikur këto fjalë nuk pranoheshin. Kjo për të thënë se truri ynë nuk mund të magazinonjë një numër të pafundëm gjuhësh, por ka një kufi".

Në fakt edhe vetë Erard, nëpërmjet intervistave me superpoliglotë të hedhura në librin e tij, flet për një limit, 10-11 gjuhë që mund të mësohen në mënyrë të përsosur, ndërkohë që gjithë pjesa tjetër është pjesë e të ashtuquajturave "bashkëbisedime të mbijetesës". Por, duke kaluar nga eksperimentet në jetën e përditshme, kupton që për të manovruar në Babelin modern duhet të dish dy apo më shumë gjuhë, dhe nuk ka shpëtim, mbi të gjitha anglishten. Kështu ak menduar në fakt Letizia Quaranta, një nënë e re poliglote, e cila është rikthyer në Itali pas disa udhëtimit jashtë dhe ka vendosur që jo vetëm të rrisë me më shumë se dy gjuhë të birin, por edhe ta ndajë këtë eksperiment me këdo që është i interesuar t'u mësojë fëmijëve gjuhë të huaja që në djep. Fëmijë që do të jenë qytetarë të botës. Ka lindur një blog dhe një faqe interneti e suksesshme, Bilingue per gioco, ku përmes një kursi të quajtur posacërisht "Learn with mummy", u mësohet të vegjëlve anglishtja që në djep.

Nëse njih një gjuhë jeton një jetë të vetme, nëse njih shumë gjuhë jeton shumë jetë. E dinë mirë të rinjtë e Erasmus, të cilët prej dy dekadash bredhin botën për të studiuar të paktën një vit në një universitet të huaj e që kthehen në shtëpi të vetëdijësuar që, sapo të marrin diplomën duhet të largohen. "Në vitet e fundit – pranon jo pa mërzë Linda Rossi Holden – shkurtimet e mësuesve dhe të orëve kanë varfëruar edhe më shumë mësimin e gjuhëve të

huaja në shkollë. Poir në fakt është e gjithë shoqëria italiane refraktare për t'u hapur ndaj shumëgjuhësisë: nuk ekzistojnë programe me titra, emisione në gjuhën mëmë. Kujtoni shqiptarët kur erdhën në Itali: shumë prej tyre e flisnin tashmë shumë mirë italishten, për arsye se prej vitesh kishin ndjekur televizionet tanë".

Jo gjithmonë kokteili i gjuhëve bëhet kulturë

Kur e pyesin sa gjuhë njih, filozofi amerikan Douglas Hofstadter fillon me një numër që nis kështu 1,97... dhe vazhdon me shifra të tjera, të gjitha në rend zbritës, pas presjes. Numri përfaqëson aftësitë gjuhësore të autorit gjenial të Goedel, Escher, Bach (dhe shumë të tjerave në një fushë të ndërmjetme mes informatikës, logjikës, fizikës dhe semiotikës). I-shi është aftësia që Hofstadter ka në anglisht. Pas kësaj, që është gjuha mëmë, vijnë gjuhët e mësuara, ato që ai i njih vetëm pjesërisht: 9 është për 9 të dhjetat e aftësisë që ka në frëngjisht, 7 në italisht e kështu me radhë.

Në kohën kur fliste, numri më i vogël i shkonte rusishtes, që sapo kish nisur ta studionte me qëllim që të mbërrinte deri aty sa të përkthente Onjeginin e Pushkinit (gjë që më vonë arriti ta bëjë, që tregon se vota që filozofi i jepte rusishtes më pas është bërë mjaftueshëm). Mund të shtrihet ky sistem i cuditshëm nga një folës i vetëm, në një gjuhë të tërë apo një kulturë të tërë. Sa anglisht "di" gjuha italiane? Sa frëngjisht? Sa rusisht, sa turqisht?

Gjuhët shërbejnë për të komunikuar dhe komunikojnë edhe mes tyre, duke mikpritur, vizituar, kontaminuar njëra tjetrën. U ndodhte imigrantëve, me shembujt e Little Italy-ve të shumta

të përhapura nëpër botë: gjuha italiane dhe gjithnjë e më shpesh dialekti i lindur u shtoheshin gjuhës që takonin në vendin ku shkonin; ndërkohë, dialekti dhe italishtja e tyre nuk ndiqnin më evolucionin e gjuhës që vazhdohej të flitej në atdhe dhe me kalimin e dekadave janë kristalizuar kështu zhargone që nuk janë lehtësisht të klasifikueshëm.

Këshilla që u jepet gjithmonë cifteve të përzier është të edukojnë fëmijët të mësojnë si gjuhën mëmë, ashtu edhe atë të babait, por duke u përpjekur ti mbajnë të dallueshme, pra të përzihen sa më pak. Eshtë një këshillë që duhet të ndjekin dhe kulturat: nuk duhet të përzihet anglishtja me italishten, duke krijuar gjoja zhargonin e "formatimit" dhe të "implementimit". Por edhe këtu ka një risk: ai i specializimit të gjuhëve. Nëse për shembull tendenca e universiteteve italianë për të krijuar kurse universitarë tërësisht në gjuhën angleze do të bëhet dominuese, mos vallë do të arrihet që të përjashtohet tërësisht italishtja nga fusha si ajo ekonomike, për shembull? Atëherë duhen mësuar më shumë gjuhë, të mbahen të dalueshme rast pas rasti, por të flitet gjithçka në secilën prej tyre, sic kanë bërë gjithmonë studiuesit e letërsive të krahasuara. Në fakt, tendenca e përgjithshme shkon drejt përzierjes. E shohim këtë gjë për shembull kur një fjalë si "stage", tashmë shumë e zakonshme, prononcohet vazhdimisht sikur të jetë anglisht, ndërkohë që është fjalë franceze. Por ndërkohë që një gjuhë si italishtja përshembull nuk ka arritur ende të ngatërrohet me anglishten, të rinjtë kanë nisur të studiojnë gjuhën kineze: dhe herët a vonë edhe ideogramet dhe tonemat do të fillojnë të fitojnë vlerë, mes të dhjetave të numrit të Hofstadter. / Focus – Bota.al



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Chelsea kërkon fitoren e parë ndaj Milanit

“Epoka e re”

LONDËR, 4 TETOR - Tifozët e Chelseat shpresojnë t'i gëzohen fitores në ndeshjen e tretë në Ligën e Kampionëve, derisa për kundërshtar e kanë skuadrën e Milanit në “Stamford Bridge” në kuadër të Grupit E. Skuadra e Graham Potterit qëndron është e fundit në grup me një pikë, ndërsa kuqezinjët kanë marrë katër pikë dhe janë në vendin e parë. Chelsea pritet të përballet pa Edouard Mendy dhe N’Golo Kante, kurse në dyshim janë Marc Cucurella dhe Carney Chukwuemeka. Ndërsa Milani do të jetë pa Theo Hernandez, Mike Maignan, Zlatan Ibrahimović, Divock Origi, Junior Messias, Alessandro Florenzi, Simon Kjær, Alexis Saelemaekers dhe Davide Calabria. Ndërsa në ndeshjen tjetër të këtij grupi do të përballen Salzburgu dhe Dinamo Zagrebi që kanë filluar



FORMACIONET E MUNDSHME

Chelsea: Kefa; James, Fofana, Silva, Chilwell; Mount, Kovačić, Gallagher; Havertz; Aubameyang, Sterling.
Milan: Tatarusanu; Dest, Kalulu, Tomori, Ballo-Toure; Tonali, Bennacer; Krunic, De Ketelaere, Leao; Giroud.

mirë në këtë edicion.

Ndeshje tjetër sonte në garën më të fortë në futboll zhvillohet në Spanjë në mes të Sevilës dhe Borussia Dortmundit. Sevilla do

të kërkojë ta regjistrojë fitoren e parë në këtë edicion, kurse gjermanët kanë një fitore dhe një humbje. Punë më të lehtë në Grupin G do të këtë Manchester

GRUPI E				GRUPI G			
18:45 Salzburg - Dinamo Zagreb 21:00 Chelsea - Milan				21:00 Manchester City - Copenhagen 21:00 Sevilla - Borussia Dortmund			
Tabela				Tabela			
1. Milan	2	4 pikë	1. Manchester City	2	6 pikë		
2. Dinamo Zagreb	2	3	2. Borussia Dortmund	2	3		
3. Salzburg	2	2	3. Copenhagen	2	1		
4. Chelsea	2	1	4. Sevilla	2	1		
GRUPI F				GRUPI H			
18:45 Leipzig - Celtic 21:00 Real Madrid - Shakhtar Donetsk				21:00 Benfica - Paris Saint Germain 21:00 Juventus - Maccabi Haifa			
Tabela				Tabela			
1. Real Madrid	2	6 pikë	1. Paris Saint-Germain	2	6 pikë		
2. Shakhtar Donetsk	2	4	2. Benfica		2	6	
3. Celtic	2	1	3. Juventus		2	0	
4. Leipzig	2	0	4. Maccabi Haifa		2	0	

City që e pret Copenhagenin. Interesant është edhe situata në Grupin H, ku PSG-ja dhe Benfica, që kanë nga 6 pikë të grumbulluara, sonte synojnë

suksesin e tretë radhazi. Në anën tjetër Juventus që ka dy humbje e ka shansin e fundit për t'i ruajtur shanset për kualifikim me fitore ndaj Maccabi Haifas.

Trepça - Ylli sonte përballen në gjysmëfinalen e Superkupës Mbarëkombëtare

Mitrovicë, 4 tetor - Spektakli në Mitrovicë është i garantuar. Më 5 dhe 6 tetor organizohet Superkupa Mbarëkombëtare. Përveç ndeshjeve të bukura në parket, pritet një organizim i jashtëzakonshëm. Nga ora 19:00 përballen Trepça dhe Golden Eagle Ylli në ndeshjen gjysmëfinale. Mitrovicasit luajnë pasi fituan Kupën e Kosovës, ndërsa therandasit si kampionë të Kosovës. Këto dy skuadra u përballën edhe në finale të “play-off”-it të Kosovës, ku Ylli kishte triumfuar 3:1 në serinë finale dhe u shpall kampion i Kosovës. Për Trepçën kjo do të jetë ndeshja e parë në Ligën Unike. Ndërkohë, verdhezinjtë kanë fituar edicionin e fundit të Superkupës Mbarëkombëtare dhe kishin triumfuar në edicionin e parë të Ligës Unike. Atmosfera pritet të jetë e jashtëzakonshme, pasi interesimi është i madh.



Mitrovicasit ditë më parë organizuan për mrekulli kualifikimet e FIBA Europe Cup dhe shpresojnë në një tjetër organizim madhështor për Superkupën Mbarëkombëtare ashtu siç i takon kësaj gare. Fituesi i kësaj ndeshje në finale do të përballet me Tiranën që, në fakt, është dashur të luajë ndaj Teutës,

por durrsakët kanë probleme shëndetësore dhe ndeshja e parë gjysmëfinale nuk do të zhvillohet. Finalja e madhe do të zhvillohet të enjten nga ora 20:00, ku do të jetë i pranishëm edhe sekretari i përgjithshëm i FIBA-s, Andreas Zagklis. Kjo është vizita e tij e parë në Kosovë dhe do të qëndrojë më 6 dhe 7 tetor.

Qerimi shpall listën për ndeshjet me Malin e Zi dhe Slloveninë

PRISHTINË, 4 TETOR - Përzgjedhësi i Kosovës në hendboll, Bujar Qerimi, ka shpallur listën e hendbollistëve në të cilët llogarit për ndeshjet e para kualifikuese për “Euro 2024”. Kosova është pjesë e grupit të shtatë ku bëjnë pjesë edhe Sllovenia, Mali i Zi dhe Bosnjë-Hercegovina. Kosova më 12 tetor në Podgoricë luan me Malin e Zi, ndërsa më 16 tetor e pret Slloveninë në Prishtinë. Në listë janë 18 lojtarë. Atdhe Basholli, Matej Taci dhe Arianit Nimanaj janë ftuar për herë të parë. Ndërkohë janë kthyer Rron Ramadani, Flamur Gërbeshi e Leonard Gegaj. Për shkak të një lëndimi, në këto ndeshje mungon kapiteni Valon Dedaj, ndërsa



LISTA E HENDBOLLISTËVE

Agon Bajqinovci, Kastriot Jupa, Flamur Gërbeshi, Drenit Tahirukaj, Arbios Mushkolaj, Luigj Quni, Festim Mustafa, Drilon Tahirukaj, Lulëzim Shabani, Haris Berisha, Jon Muqolli, Leonard Gegaj, Rron Ramadani, Atdhe Basholli, Arianit Nimanaj, Egzon Gjuka, Matej Taci, Liridon Zena.

Bujar Ramosaj mungon për shkak të obligimeve personale. I lënduar është edhe Shaban Zogaj. Grumbullimi i lojtarëve bëhet më 8 tetor në Prishtinë.


Kosova anulon pjesëmarrjen në Kampionatin Ballkanik të Xhudos për shkak të vizave

Pejë, 4 tetor - Trajneri i xhudos Driton Kuka ka njoftuar se është dashur ta anulojnë pjesëmarrjen në Kampionatin Ballkanik U13 të Xhudos që mbahet në Sarajevë si pasojë e procedurave të stërzgjatura për t'u pajisur me viza. Ai ka thënë se pas disa javësh një kampionat i tillë në Sarajevë do

të mbahet edhe për grupmoshat U23 dhe nga frika se mund të kenë telashe me viza, tashmë për garuesit që do të udhëtojnë atje kanë aplikuar për pasaportë në Shqipëri. “Ditë më parë na u desh të anulohet një garë për fëmijët, gjegjësisht në Sarajevë atje u mbajt Kampionati Ballkanik

U13! Arsyeya – procedura të tepërta për pajisje me vizë rrjedhimisht koha e shkurtër. Pas disa javësh në Sarajevë do të mbahet Evropiani U23 dhe mesin e garuesve do të jenë edhe Erza, Riosi e Laura, pretendentë për medalje. Prapë procedura e probleme me viza. Për garuesit e

sipërpërmendur kemi aplikuar edhe për pasaportë shqiptare për evitim të problemeve të tilla. Me shpresë për mirëkuptim nga qeveria e shtetit tonë amë! Me Federatën e Bosnjës kemi marrëdhënie të shkëlqyeshme, por pjesa politike e tyre është ndryshe”, ka thënë Kuka.



'La Gazzetta dello Sport': Di Biagio kandidat për ta marrë drejtimin e Shqipërisë

TIRANË, 4 TETOR - Miqësorja në mes të Shqipërisë dhe Italisë më 16 nëntor në Shqipëri mund të sjellë një protagonist të ri në krye të kuqezinjve. Trajnerit aktual të kombëtares kuqezi, Edy Reja, i përfundon kontrata në

muajin nëntor dhe nuk do ta rinovojë atë. Sipas asaj që raporton gazeta më e madhe në Itali, "La Gazzetta dello Sport", Shqipëria po mendon për një tjetër trajner italian, Luigi Di Biagio. Ai shihet si pasuesi më i mundshëm i

Rejas dhe pëlqehet shumë nga kreu i FShF-së, Armand Duka. Di Biagio ka drejtuar edhe Italinë për dy ndeshje në vitin 2018, para se të emërohej në krye të kombëtares "axurre", Roberto Mançini. Zyrat e FShF-së

kanë mohuar një pajtim të mundshëm me Di Biagion në një reagim të bërë së fundmi, por që gjithsesi nuk përjashtohet mundësia që ai të jetë pasuesi i Rejas dhe të shohim sërish një italian në krye të kombëtares shqiptare.



Robertsoni bëhet pishman: Nuk respektova më të mirin e historisë

LIVERPOOL, 4 TETOR - Mes shumë ndeshjeve të luajtura me Barcelonën, Leo Messi sigurisht se nuk e ka shumë mirë kujtesën e ndeshjes në "Anfield" kundër Liverpoolit. Në vitin 2019 "Reds" përmbysi disavantazhin 3-0 në "Camp Nou", çka dukej si "gur varri" i aspiratave të tyre për ta fituar Ligën e Kampionëve.

Asnjë frikë nga skuadra e Kloppit ndaj 10 blaugranave, pavarësisht se në ndeshjen e parë "Pleshti" kishte krijuar kaos, madje duke e "shpuar" Alisson me një goditje dënimi të çmendur. Robertsoni shpjegoi se nuk ia kërkoi fanellën yllit argjentinas.

Mbrojtësi skocez e shpjegoi këtë moment për "podcastin" e Peter Crouchit, duke i treguar ish-sulmuesit të kombëtares së Anglisë skenën që tashmë është kthyer në një nga simbolet e një ndeshjeje legjendare. Pak minuta pas vërshëllimës fillestare, Robertsoni dhe Messi përfunduan të dy në tokë: "Bashkë me Fabinho po e ndiqnim, teksa unë dhe Messi ramë në tokë. I tërhoqa pak flokët. Ai nuk ishte



shumë i lumtur, por është diçka që nuk do ta bëja më. Ishte mungesë respekti për futbollistin më të mirë të të gjitha kohëve". Messi, në fakt, nuk e ka marrë mirë, por krahasuar me dramën që do të jetonte në "Anfield", përmbysjen e madhe të të kuqve, ishte absolutisht asgjë. Robertsoni shpjegon se ai gjest pothuajse erdhi instinktivisht, sepse atë natë "Anfield" ishte një "ferr" i vërtetë i kuq dhe skocezi u rrembye: "Ajo

ndeshje ishte e veçantë dhe nuk mund ta përmbante askush veten. Nuk kam përjetuar kurrë një atmosferë të tillë. Ishim shumë të emocionuar për ndeshjen. Më vjen keq që e bëra, edhe sepse është një gjest që të gjithë mendojnë tani kur flasin për mua, që nuk është më i miri i jetës. Nuk po mendoja për atë që po bëja. Po ta kisha menduar nuk do ta kisha bërë kurrë një gjë të tillë".

Wolff : Hamiltoni do të jetë me Mercedesin edhe përtej moshës 40-vjeçare

LONDËR, 4 TETOR - Sezoni 2022 nuk ka qenë ai që pritej për Mercedesin, që prej kohësh po sheh për vitin e ardhshëm. Makina gjermane synon të rikthehet kompetitive edhe për faktin se viti 2023 është i fundit nën kontratë me Lewis Hamilton. Pa një makinë të shpejtë, vështirë se britaniku do ta rinovojë kontratën me Mercedesin. Gjithsesi, shefi i Mercedesit, Toto Wolff, është i sigurt se piloti britanik do të qëndrojë edhe pasi të skadojë kontrata aktuale. Madje ai shton se Hamiltoni mund të garojë dhe të jetë kompetitiv edhe përtej moshës 40-vjeçare. "Jam i sigurt se herët a vonë do të ulemi në një tryezë e do të diskutojmë për kontratën e re", ka thënë Wolff. "Ne jemi rritur së bashku, ne si skuadër dhe ai si pilot, ndaj jemi transparentë. Lewis do të jetë i



pari që do të na thotë se 'nuk ia dal dot më dhe nuk argëtohem më si dikur'. Ai është një personalitet në Formula 1 dhe mendoj se me

talentin që ka mund të garojë përtej moshës 40-vjeçare, duke qëndruar sërish me ne", ka deklaruar Wolff.

SHKURT

Verstappen: Singapori, një dështim, në Japoni gati ta hapë shampanjën

Max Verstappen zhgënjeu në garën e zhvilluar në Singapor, ku u klasifikua në vendin e shtatë. Piloti holandez i Red Bullit pati një fundjavë të keqe, ku të shtunën u penalizua nga gabimet e skuadrës, ndërsa të dielën ishte vetë ai që gaboi në 2-3 raste gjatë garës. Gjithsesi, ai ruan një avantazh të madh me Charles Leclerc (i dyti me 104 pikë diferencë) dhe mund të festojë këtë fundjavë në garën që zhvillohet në Japoni. "Do të ishte diçka fantastike, që pas një zhgënjimi të vinte një fitore, pse jo edhe titulli", ka thënë Verstappen. "Nuk duhet t'i përsëritim gabimet e garës së Singaporit. Nuk mendoj se afrimi të titulli po në vë nën presion, pasi vjet ka qenë edhe më e vështirë dhe delikate situata. Në Singapor, thjesht gabuam por, për fat, ka ende edhe pesë gara. Ne dëshirojmë ta festojmë sa më shpejt titullin", ka shtuar Verstappen.

Ronaldo në janar do të largohet nga Unitedi

Cristiano Ronaldo do të ndahet zyrtarisht nga Manchester Unitedi në muajin janar. Mosaktivizimi në ndeshjen e fundit kundër Manchester Cityt në derbi, ka sjellë dhe goditjen e fundit të marrëdhënieve mes tyre. Ronaldo ka luajtur vetëm 80 minuta në Premierë Ligë dhe nuk është titullar që nga humbja 0-4 ndaj Brentfordit. Pesë herë fituesi i "Topit të Artë" tentoi që të largohej në verë, por agjenti i tij Jorge Mendes nuk finalizoi asnjë marrëveshje me ndonjë klub të madh. Ronaldo refuzoi një propozim nga ekipi i Al-Hilal për dy sezone, ku do të fitonte 242 milionë euro. Marrëdhëniet me trajnerin Ten Hag nuk kanë qenë asnjëherë të mira dhe tashmë duket se është momenti që ai të tentojë një aventurë të re në janar, ku Chelsea mund të jetë një opsion mjaft i mirë për të.

Ozili operohet me sukses

Mesut Ozili, që luan për Basaksehirin në Superligën turke, i është nënshtruar një ndërhyrjeje kirurgjikale. Pas kësaj ndërhyrjeje mesfushori i njohur do të qëndrojë larg fushave të blerta për disa muaj. Skenari më pozitiv për rikthimin e tij pritet të jetë 3 muaj, megjithatë gjithçka do të varet nga procesi i rikuperimit. Për fat, operimi doli me sukses dhe vetë Ozili e sqaroi diçka të tillë nëpërmjet një reagimi në rrjetet sociale. Ozil u transferua këtë verë nga Fenerbahçe te Basaksehiri teksa në këtë sezon mes paraqitjeve në kampionat, kualifikueset evropiane dhe Ligën e Konferencës mesfushori ka grumbulluar vetëm 21 minuta.

Leonard rikthehet në fushë pas 15 muajsh, Miami rinovon kontratën me Herron

Lajme të mira për skuadrën e Clippersit. Basketbollisti Kawhi Leonard, dy tituj kampionë në NBA dhe dy herë MVP i finaleve, është rikthyer në fushë pas 15 muajsh. Ai u lëndua më 14 qershor 2021 dhe vjet nuk u aktivizua, ndaj për kalifornianët ky rikthim është si një përforcim i rëndësishëm. Ylli i Clippersit luajti për herë të parë në miqësoren që skuadra e tij fitoi 102-97 ndaj Portlandit, duke realizuar 11 pikë e 4 rebounde. "Ishte diçka e mrekullueshme. Ishte një test i mirë i një pune që kam bërë muajt e fundit. Më mungonte kjo atmosferë, skuadra, gjithçka. Një përvojë fantastike", ka thënë Leonard, që luajti 16 minuta. Ndërkohë, një javë nga fillimi i sezonit të ri (2022-2023), ekipi i Miami Heat ka rinovuar kontratën me yllin e saj Tyler Herro. Një marrëveshje e re për 4 vitet e ardhshme, nga e cila basketbollisti do të përfitojë 130 milionë dollarë. Nga kontrata e mëparshme ai përfitonte 17 milionë dollarë për 4 vjet, ndërsa tani shuma është 10-fishuar.

Van Der Vaart kritikon Ten Hagin: Idiotësi zgjedhja e McTominay para Casemiros

Një goditje e minutës së fundit ishte ajo e Manchester Unitedit me transferimin e Casemiros nga Real Madridi. Anglezët shpenzuan plot 70 milionë paund për

mesfushorin, por trajneri Erik Ten Hag çuditërisht e ka lënë në stol duke i besuar Scott McTominay. Një zgjedhje që, sipas ish-futbollistit Rafael van Der Vaart, është një

idiotësi e teknikut holandez të "Djajve të Kuq", pasi në këtë formë i hap probleme vetes. "Ten Hag duhej të kishte hedhur në fushë nga minuta e parë Casemiron në derbin

ndaj Manchester Cityt. Unë e kuptoj, skuadra nisi të fitonte me McTominay në fushë dhe ishte e vështirë ta përjashtoj nga 11-shja titullare. Por e theksoj se kjo zgjedhje e Ten

Hagut më duket një idiotësi pasi në këtë formë vetëm sa i hap probleme vetes", ka thënë ish-futbollisti i Real Madridit dhe Tottenham Hotspurit.



Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2, dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më datë 01.12.2010, lidhur me nenin 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, nenit 11, nenit 21 nën par. 2.2 dhe nenit 25 të Rregullores nr. 55/21 për Marrëdhënien e Punës të N.P.L. "Përparimi" Sh. A., në Vushtrri e miratuar me datë 21.12.2021 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L. "Përparimi" Sh. A - Vushtrri,, e duke u bazuar në vendimin me nr. 1053/22 të datës 03.10.2022 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L. "Përparimi" Sh. A me datë 04.10.2022 shpall:

KONKURS PUBLIK

(Për plotësimin e vendeve të lira të punës "Pastrues të Zyrave dhe Objekteve")

- I. Titulli: Pastrues i Zyrave dhe Objekteve
 Numri i ekzekutuesve: 5
 Orët e punës: 40 orë në javë
 Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.
 Përgatitja profesionale: Shkolla fillore
 Përvoja e punës: Nuk kërkohet përvojë pune
 I raporton: Udhëheqësit të njësisë së mirëmbajtjes-pastrimit të zyrave dhe objekteve
 Koeficienti i pagës: 3.2.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Do të bëjë pastrimin e zyrave dhe objekteve varësisht nga marrëveshjet që ka punëdhënësi me palët e treta;
- Do të bëjë ruajtjen e mjeteve të punës të cilat përdoren për pastrim;
- Do të pastrojë të gjitha hapësirat për të cilat udhëzohet nga eprori;
- Do të ndjekë rregullat e higjienës dhe rregullat e sigurisë sipas udhëzimeve të eprorit si dhe përgjegjësitë e tjera të cilat ndërliken me vendin e punës dhe në bazë të kërkesës së eprorit;
- Për punën që kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njësisë së Mirëmbajtjes-Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve;
- Kryen dhe punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L. "Përparimi" Sh. A - Vushtrri;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (Diploma të sille të noterizuar);
- Ekstraktin e lindjes (Duhet të jetë origjinal);
- Dëshmitë për përvojën e punës (Nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit;

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin dhe ta dorëzojnë në zyrat e N.P.L. "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastriot Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtrri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe e-mail adresën. Shpallja është e hapur nga data 05.10.2022 deri me datë 19.10.2022 në ora 16:00.

N.P.L. "Përparimi" Sh. A në Vushtrri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Për informata shtesë mund të kontaktoni në këtë nr.tel. 044 - 732 - 058.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.



Na osnovu članom 8, članom 10 pod st. 2.2, član 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljen u Službeni list Republike Kosovo, od dt. 01.12.2010, u vezi sa članom 5 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o regulisanje procedura konkursa na javnom sektoru koji je deo Zakona br. 03/L-212 o radu, koji je objavljen u Službenom listu Republike Kosovo od dt. 31.10.2017, i člana 11, člana 21. pod st. 2.2 i člana 25 Uredbe 55/21 o radnim odnosima NPL „Përparimi“ Š. A. u Vučitrnu odobreno 21.12.2021, a na osnovu odluke br. 1053/22 od 03.10.2022, godine glavnog izvršnog direktora N.P.L. „Përparimi“ Š. A od 04.10.2022 saopštava:

JAVNI KONKURS

(Za popunu radnih mesta „Čistač kancelarija i objekata“)

- I. Naslov: Čistač kancelarija i objekata
 Broj izvršilaca: 5
 Radno vreme: 40 sati nedeljno
 Trajanje imenovanja: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja
 Stručna priprema: Osnovna škola
 Radno iskustvo: Nije potrebno radno iskustvo
 Izveštava: Rukovodioci jedinice za održavanje – čišćenje kancelarija i objekata
 Koeficijent plate: 3.2

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Čistiće kancelarije i objekte u zavisnosti od ugovora koje poslodavac ima sa trećim licima;
- Čuvaće radni alat koji se koristi za čišćenje;
- Očistiće sve prostore za koje je upućen od pretpostavljenog;
- Pridržavaće se pravila higijene i bezbednosti prema uputstvima pretpostavljenog kao i druge obaveze vezane za radno mesto a na osnovu zahteva pretpostavljenog
- Obavlja i druge poslove po nalogu uprave preduzeća;

Uz prijavu se mora priložiti sledeće:

- Obrazac prijave za NPL „Përparimi“ Š. A.;
- Dokaz o školskoj spremi (diploma mora biti ovjerena);
- Izvod iz matične knjige rođenih (mora biti original);
- Dokaz o radnom iskustvu (ako postoji, nije obavezan);
- Kopija lične karte;

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja.

Zainteresovani kandidati mogu primiti i predati prijavni formular u kancelarijama NPL „Përparimi“ Š. A u gradu Vučitrnu, ul. „Gjergj Kastriot Skenderbeu“ br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – filijala u Vučitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kandidati koji konkurišu moraju da unesu tačnu adresu, kontakt telefon i e-mail adresu. Oglas je otvoren od 05.10.2022.godine do 19.10.2022.godine u 16:00 časova.

Za dodatne informacije možete se obratiti na ovaj broj telefona. 044/732 058.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene, a nepotpune prijave će biti odbijene.


KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" SH.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 03.06.2022 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që me datë 05.10.2022 të rishpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendeve të punës:

Tre (3) Punëtor Fizik -Njësia në Vushtrri me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave në automjete – kamion kompaktor dhe traktor;
- Zbrazen e konteinerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre nga zona e shërbimit gjerë në deponi;
- Kryen pastrimin, larjen dhe spërkatjen e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve;
- Kryen punët e grumbullimit të mbeturinave në konteiner, kryen punët rreth pastrimit të borës, hedhjes së kripës industriale, heqjen e akullit;
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve;
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të konteinerëve gjatë punës, kryen edhe punë tjera të natyrës së ngjajshme të cilat i cakton udhëheqësi i tij i drejtëpërdrejtë.

Kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë diplomën e shkollës fillore ose të mesme;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Kushtet e veçanta:

Punëtori gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mundë të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 05.10.2022 deri më datën 19.10.2022. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Ibex Energy Kosovo" SH.P.K. Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. Unik Identifikues: 811489534 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Ibex Energy Kosovo" D.O.O. Pristin, donelo odluku o prestani rada sa Unik Identifikues: 811489534 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Ibex Energy Kosovo" L.L.C. Pristin, has come to the decision to quit its business Unik Identifikues: 811489534 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.


KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" SH.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 03.06.2022 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që me datë 05.10.2022 të rishpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendeve të punës:

Një (1) Punëtor Fizik -Njësia në Skënderaj me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave në automjete – kamion kompaktor dhe traktor;
- Zbrazen e konteinerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre nga zona e shërbimit gjerë në deponi;
- Kryen pastrimin, larjen dhe spërkatjen e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve;
- Kryen punët e grumbullimit të mbeturinave në konteiner, kryen punët rreth pastrimit të borës, hedhjes së kripës industriale, heqjen e akullit;
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve;
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të konteinerëve gjatë punës, kryen edhe punë tjera të natyrës së ngjajshme të cilat i cakton udhëheqësi i tij i drejtëpërdrejtë.

Kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë diplomën e shkollës fillore ose të mesme;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Kushtet e veçanta:

Punëtori gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mundë të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 05.10.2022 deri më datën 19.10.2022. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Kosovo Israel Properties" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70500825.

- Jahë Jaha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.Teknike "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

- Luan Cillingeri shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - Vdhe VI - IX shfmu " Dëshmorët e Zhurit " Zhurë.

- Diana Brovina shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Sami Frashëri".

- Nezir Morina shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Saranda Preniqi shpall të pavlefshme dokumentet e shkollës së mesme "Eqrem Çabej" Prishtinë.

- Vigane Balaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Pjeter Budi " Lubizhde e Hasit " Hasë.

- Edonis Gashi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. së dhjetë të shkollës së mesme profesional "Prenk Jakova" Prishtinë.

- Armend Musaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Hysen Rexhepi " Prizren.

- Dr. Qamile Morina shpall të pavlefshme Licencën e Punës të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës me nr: KO-00549-01-01.

- "Prima Studio" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811473280.

- Rema Fazli Osmani Fushë Kosovë shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Eqrem Çabej".

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- D.P.T "Beni" shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. Të biznesit 70488671.



**ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales